VENDIM
Nr.129, datë 6.12.2011

PËR CAKTIMIN E EKSPERTIT QË DO TË PËRFAQËSOJË ERE-N NË PANELIN RISHIKUES TË KËRKUAR NGA "CEZ SHPËRNDARJE" SHA

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar të ligjit nr.10 126, datë 11.5.2009 "Për miratimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a.", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e "CEZ shpërndarje" sh.a. me shkresën nr.6571, prot., datë 23.11.2011, për ngritjen e panelit rishikues për vendimet e ERE-s që lidhen me miratimin e tarifave të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike, si dhe informacionet e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të caktojë KPMG-në në cilësinë e ekspertit që do të përfaqësojë ERE-n në panelin rishikues të kërkuar nga "CEZ shpërndarje" sh.a., lidhur me vendimet e ERE-s që lidhen me miratimin e tarifave të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë "CEZ shpërndarje" sh.a., dhe METE për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani